



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 130 Prot.

Tiranë, më datë 14.02.2025

VENDIM

Nr. 118, datë 14.02.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saç”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.02.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor të zonës ku shtrihet projekti “*TEG-Zgjerimi*”, Lundër, me subjekt zhvillues **Tirana East Gate shpk** dhe subjekt ndërtues **MANE TCI shpk**;
 2. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2 dhe nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen sipas përcaktimeve të neneve 145 - 147;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Joli MITROJORGJI

KRYETAR
Blendi GONXHJA